



Pranuar / Dorëzuar Punëjohë/Protokoll Received/Delivered		19-04	2023	3	viti god year
Organ /Aqesia Organ /Jedimca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shojca Prilog Appendix		Sasia Kolicitna Quantity	
SKPMSHUK	3700/2023			113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.514/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kane shqyrtuar ankesën me numër A.nr.514/2023 të datës 15.03.2023 të parashtruar nga ankuesi, kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës ne pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 19.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.514/2023 e datës 15.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civile i punësuar në Komunën e Ferizajt, më datë 15.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër veprimit administrativ të Komunës së Ferizajt si dhe Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë - Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me kategorizimin e pozitës se tij të punës në Kategorinë Profesionale 3.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 27.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Ferizajt, ndërsa me datë 05.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shpresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Aktin e Emërimit të datës 07.03.2019, rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Zyrtarë për Gjendje Civile* në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme në Komunën e Ferizajt, me koeficient të pagës, pesë (5), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesi, me datë 15.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Komuna e Ferizajt si dhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publikë - Ministria e Punëve të Brendshme, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, me datë 05.02.2023, ka kategorizuar ankuesin në Kategorinë Profesionale 3, përkundër se i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore për Kategorinë Profesionale 2, të parashikuar në Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj"*, dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Ferizajt, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficientëve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë profesionale 3 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë




fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.514/2023

Vjollca SINANI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI - BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajt; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

